- Pushimin e shqyrtimit për shkak të dorëheqjes nga marka ose nga kërkesa për kundërshtim, në 6 raste.
- 5 prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 7 prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

Gjatë vitit 2014, janë ndjekur 23 çështje gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në të cilat DPPM është thirrur si palë e paditur ose person i tretë, nga të cilat:

- 3 çështje kanë pasur si objekt, shfuqizimin e një marke të regjistruar, për arsye të cënimit të të drejtave të një marke të mëparshme ;
- 5 çështje kanë pasur si objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelit të marrë lidhur me kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të një marke të publikuar për shkak të shkeljes së të drejtave të mëparshme ;
- 2 çështje ka pasur si objekt ndalim konkurrence të paligjshme.
- 3 çështje kanë pasur si objekt, pavlefshmëri marke;
- 1 çështje ka pasur si objekt, pushimi i cënimit të të drejtave ;
- 5 çështje kanë pasur si objekt zhvlerësimin e një marke të regjistruar ;
- 1 çështje ka pasur si objekt konkurrencë e pandershme;
- 2 çështje ka pasur si objekt ndalim përdorim marke;
- 1 çështje ka pasur si objekt pagim shume për përdorim patente.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2014 ka marrë vendim për 2 çështje me palë DPPM, duke vendosur :

- Këto 2 (dy) çështje me objekt shfuqizimin e një marke të regjistruar.
- Gjatë vitit 2014, sektori juridik ka ndjekur 16 çështje gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë ku është thirrur

II. PROCEDURES BEFORE BOARD OF APPEAL AND COURT

During 2014, the Board of Appeal decided on 32 cases as follows:

- In 11 cases it was decided to accept the request and reject the application;
- Rejection of the request and continuing the trademark registration procedures in 12 cases;
- Rejection for the review of the request in 3 cases;
- The suspension of the review due to withdrawal from the trademark or from requests for opposition of the application in 6 cases;
- 5 of the Board decisions have been appealed at Judicial District Court of Tirana and 7 of the Board decisions have been appealed at the First Instance Court.

During 2014, have been followed 23 cases in the Judicial District Court of Tirana, where GDPT has been called as defendant or third person, out of which:

- The subject of 3 cases was the abrogation of a registered trademark due to violation of the rights of a previous trademark;
- The subject of 5 cases was the appeal of a decision from the Board of Appeal on the request to abrogate the registration of a published trademark due to the violation of previous rights;
- The subject of 2 cases was the termination of illegal competition;
- The subject of 3 cases was the invalidity of a trademark;
- The subject of 1 case was the termination of the violation of rights;
- The subject of 5 cases was the devaluation of a registered trademark;
- The subject of 1 case was unfair competition;
- The subject of 2 cases was the prohibition to use a trademark;
- The subject of 1 case was the payment for the use of patent.

Tirana Judicial District Court during 2014 has decided on 2 cases having GDPT as a party, thus deciding:

- These 2 (two) cases aiming to abrogate a registered trademark.
- During 2014, the judicial sector has followed up on 16 court cases at Tirana First Instance Court, being summoned as defendant and third party. The subject of the cases were the appeal of a decision from the Board of Appeal

si palë e paditur dhe personi i tretë. Çështjet kanë pasur si objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelimit të marrë lidhur me kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të një marke të publikuar për shkak të shkeljes së të drejtave të mëparshme, deklarim i pavlefshëm i urdhërit për largimin nga puna dhe përjashtim gjyqtari :


- 8 çështje, kanë pasur si objekt anulimin e vendimit të Bordit të Apelimit të DPPM;
- 6 çështje kanë pasur si objekt shfuqizimin e aktit administrativ;
- 1 çështje ka pasur si objekt deklarimin e pavlefshmërisë së Urdherit Nr.02, datë 03.01.2014;
- 1 çështje ka pasur si objekt përjashtim gjyqtari.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë gjatë vitit 2014 ka marrë vendim për 5 çështje me palë DPPM duke vendosur:

- 2 çështje është lënë në fuqi vendimi i Bordit të Apelimit të DPPM
- 1 çështje është shfuqizuar vendimi i Bordit të Apelimit të DPPM
- 1 çështje është marrë vendimi për pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë për shfuqizimin e Urdherit për largimin nga puna
- 1 rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga pala paditëse.

Gjatë vitit 2014, sektori juridik ka ndjekur 5 çështje gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë,

- 4 çështje me objekt shfuqizim rregjistrim marke
- 1 çështje me objekt zhvlerësim marke



Gjykata e Apelit Tiranë gjatë vitit 2014 ka vendosur për 2 çështje:

- 1 çështje ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shfuqizimin e regjistrimit të markës ;
- 1 çështje ka vendosur rrëzimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zhvlerësimin e vendimit të Bordit.

Gjatë vitit 2014, sektori juridik ka ndjekur 2 çështje gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me objekt shfuqizimi i vendimit të bordit të apelimit dhe shfuqizim patente.

on the request to abrogate the registration of a published trademark due to the violation of previous rights; invalid statement of the order for an employment termination order and expulsion of a judge:


- 8 cases aiming at the cancellation of the decision of GDPT Board of Appeal;
- 6 cases aiming the abrogation of an administrative act;
- 1 case aiming at the declaration of invalidity for Order no. 02, dated 03/01/2014;
- 1 case aiming to expel the judge.

Tirana First Instance Court during 2014 has decided on 5 cases having GDPT as a party, thus deciding:

- In 2 cases prevailed the decision of GDPT Board of Appeal;
- In 1 case the decision of GDPT Board of Appeal has been abrogated;
- In 1 case has been decided on the partial approval of the complaint to abrogate the employment termination order;
- In 1 case the rejection of the plaintiff request to expel the judge.

During 2014, the judicial sector has followed up on 5 court cases at Tirana Court of Appeal.

- 4 cases aiming at the abrogation of trademark registration;
- 1 case aiming at the devaluation of a trademark.



In 2014, Tirana Court of Appeal has decided on 2 cases:

- In 1 case it was decided on the prevail of the decision of Tirana Judicial District Court on abrogation of trademark registration;
- In 1 case it decided on the abrogation of Tirana Judicial District Court decision on the devaluation of the Board decision;

During 2014, the judicial sector has followed up on 2 court cases with the Administrative Court of Appeal in Tirana, aiming at the abrogation of the decision of the Board of Appeal and devaluation of the patent.


Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka marrë vendime për 2 çështje duke vendosur lënien në fuqi të Bordit të Apelit.

Gjatë vitit 2014, sektori juridik ka ndjekur 4 çështje gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë Tiranë me objekt çregjistrim marke..

Për 1 çështje Gjykata e Lartë ka vendosur pezullimin e vendimit të Gjykatës së Apelit me objekt kërkesë për pezullim nga pala e paditur.

Viti	Kundërshtime Marka kombëtare	Kundërshtime Marka ndërkombëtare	Kundërshtime Patenta	Apelime Marka	Apelime Patenta	Totali
2014	35	13	0	0	2	50

Më poshtë është paraqitur në mënyrë grafike raporti midis kërkesave për kundërshtim të markave kombëtare, atyre ndërkombëtare dhe apelimit të vendimit të refuzimit të aplikimeve për patenta të paraqitura pranë Bordit të Apelit gjatë vitit 2014




Tirana Administrative Court of Appeal has decided on 2 cases in which prevails the decision of the Board of Appeal.

During 2014, the judicial sector has followed up on 4 court cases at Tirana Supreme Court aiming at the de registration of trademark.

In 1 case, the Supreme Court has decided on the suspension of the Court of Appeal decision aiming at suspension from the defendant.

Year	Opposition National trademarks	Opposition International trademarks	Opposition Patents	Appeal	Appeal Patents	Total
2014	35	13	0	0	2	50

The graphic below represents the ratio between the requests for rejection of national trademarks, international trademarks and appeals of the decision of rejection of applications for patents submitted at the Board of Appeal during 2014



III. AKTIVITETE TË DPPM

1- Zhvillimet legislative

Janë miratuar të dy projekt ligjet në fushën e Pronësisë Industriale. Aktualisht legjislacioni në fushën e Pronësisë Industriale është plotësisht i përafuar me atë të vendeve të BE.

- Ligji nr. 55/2014 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, u miratua në datën 29 Maj 2014 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, u publikua në fletoren Zyrtare nr. 96 datë 24 Qershor 2014. Ky ligj hyri në fuqi në datën 10 Korrik 2014.
- Ligji 66/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8488, datë 13.5.1999, “Për mbrojtjen e Topografisë së Produkteve Gjysëm Përçues”, u miratua në 26 Qershor 2014 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, u publikua në fletoren Zyrtare nr. 114 datë 24 Korrik 2014 dhe hyri në fuqi 08.08.2014.

Në drejtimin e harmonizimit me direktivat Europiane këto dy ligje përafrojnë plotësisht legjislacionin e PI më acquis si më poshtë:

- Direktiva 98/44/EC “Mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve teknologjike”;
- Direktiva 98/71/EC “Mbi mbrojtjen ligjore të disenjove industriale”;
- Direktiva 2008/95/EC “Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për markat tregtare dhe të shërbimit”;
- Direktiva 2004/48/EC “Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.
- Direktiva Nr. 87/54 “Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara.”

III. GDPT ACTIVITIES

1- Legislative developments

The two draft projects in the field of Industrial Property have been approved. Currently, the legislation in the area of Industrial Property is fully approximated to the one of EU countries.

- Law no. 55/2014 “On some amendments to Law no.9947 dated 07/07/2008 “On Industrial Property” was adopted on 29 May 2014 by the Assembly of the Republic of Albania and was published in the Official Journal no. 96, dated 24 June 2014. This law entered into force on 10 July 2014.
- Law 66/2014 “On some amendments and additions to Law no. 8488, dated 13.5.1999, “On the protection of Topography of Semiconductor Products” was adopted on 26 June 2014 by the Assembly of the Republic of Albania. Further, it was published in the Official Journal no. 114 dated 24 July 2014 and entered into force on 08/08/2014.

In respect of the harmonization with the European Directives, these two laws fully approximate the IP legislation to acquis as presented below:

- Directive 98/44/EC “On the legal protection of technological inventions”;
- Directive 98/71/EC “On the legal protection of industrial designs”;
- Directive 2008/95/EC “On approximation of the laws of the member states relating to trademarks”;
- Directive 2004/48/EC “On protection of the Industrial Property rights”.
- Directive No. 87/54 “On the legal protection of topography of integrated circuits”



DPPM në periudhën Korrik-Gusht 2014 hartoi, duke i konsultuar gjerësisht edhe me grupet e interesit, projekt vendimet për amendimin e akteve nënligjore si më poshtë:

- Draft rregullorja mbi disa amendamente në VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008, "Për aprovimin e rregullores në lidhje me Patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit"
- Draft rregullorja mbi disa amendamente në VKM Nr. 1706 datë 29.12.2008, "Për aprovimin e rregullores në lidhje me Markat tregtare dhe të Shërbimit"
- Draft rregullorja mbi disa amendamente në VKM Nr. 1705 datë 29.12.2008, "Për aprovimin e rregullores në lidhje me regjistrimin e treguesve gjeografikë"
- Draft rregullorja mbi disa amendamente në VKM Nr. 381 datë 08.04.2009, "Për aprovimin e rregullores në lidhje me regjistrimin e disenjove industriale"
- Draft rregullorja mbi disa amendamente në VKM Nr. 883 datë 13.05.2009, "Për aprovimin tarifave në lidhje me objektet e Pronësisë Industriale"

2- Bashkëpunimi me Institucionet vendase dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Gjatë gjithë vitit 2014 DPPM ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet vendase të përfshira në sistemin e mbrojtjes së PI, si më Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Prokurorinë dhe Gjykatën.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, DPPM gjatë vitit 2014 ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me dy organizatat më të rëndësishme në të cilat Shqipëria është anëtare, të cilat janë Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe Zyra Evropiane e Patentave (EPO). DPPM ka marrë pjesë në takime dhe komitete teknike të tyre. Është përgatitur me to projekt plani për bashkëpunim teknik për periudhën 2015-2016.

Vlen të theksohet që DPPM ka nisur bashkëpunimin me Zyrën për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (OHIM), organizatë kjo e Komisionit European për harmonizimit e tregut të brëndshëm të BE. Ky bashkëpunim përgatit rrugën për antarësim e mundshëm në të ardhmen.

In July-August 2014, after broad consultations with stakeholders, GDPT drafted the project decisions for the amendment of the below by-laws:

- Draft Regulation on some amendments to DCM no. 1706 1707 dated 29/12/2008, "On approval of the regulation concerning Invention Patents and models of use"
- Draft Regulation on some amendments to DCM no. 1706 1706 dated 29/12/2008, "On approval of the regulation concerning Trademarks and Service Marks"
- Draft Regulation on some amendments to DCM no. 1706 1705 dated 29/12/2008, "On approval of the regulation concerning the registration of geographic indications"
- Draft Regulation on some amendments to DCM no. 1706 381 dated 08/04/2009, "On approval of the regulation concerning the registration of industrial designs"
- Draft Regulation on some amendments to DCM no. 883 dated 13.05.2009, "On approval of the fees concerning the objects of of industrial property"

2- Collaboration with local institutions and international organisations

During the entire 2014, GDPT collaborated continuously with the local institutions involved in IP protection system, such as the General Directorate of Customs, the General Directorate of State Police, the Prosecution Office and the Court.

In the area of international collaboration during 2014, GDPT has collaborated closely with the two most important organisations where Albania adheres, which is the World Intellectual Property Organisation (WIPO) and European Patent Office (EPO). GDPT has participated in their meetings and technical committees. A draft project on technical cooperation has been collectively planned for 2015-2016.

It is worth mentioning that GDPT has initiated collaborating with the Office for Harmonization in the Internal Market (OHIM), an organisation of the European Commission for the harmonization of EU internal market. This collaboration paves the road to a potential future membership.

Në datën **17 Tetor 2014**, DPPM nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me QKR i cili është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri i krijuar me Ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, me qëllim zhvillimin e politikave për promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale për rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit, për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me markën tregtare dhe të shërbimit, dizenjon industriale apo treguesin gjeografik të regjistruar. Kjo marrëveshje ka për qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për njohjen e bizneseve me rëndësinë e regjistrimit të objekteve të Pronësinë Industriale si edhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Në këtë kuadër përfaqësues nga DPPM kanë trajnuar stafet e QKR-ve në rrethe respektivisht si më poshtë:

- i. Në datën 24 Tetor 2014 në Fier.
- ii. Në datën 27 Tetor 2014 në Vlorë.
- iii. Në datën 6-7 Nëntor 2014 në Gjirokastrë.
- iv. Në datën 11-12 Nëntor 2014 në Korçë.
- v. Në datën 20 Nëntor 2014 në Durrës.

Gjatë takimit stafi i QKR-së u informua mbi rëndësinë dhe procedurat e regjistrimit të objekteve të PI dhe i vuri në dispozicion QKR-ve materiale informuese për biznesin.

- Në datë **18 shkurt 2014**, u zhvillua takimi i pestë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për Bujqësinë dhe Peshkimin. Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave prezantoi në këtë takim një material për Treguesit Gjeografikë në Shqipëri, si dhe ndryshimet e bëra në projekt ligj për Pronësisë Industriale në lidhje me to. Këto ndryshime synojnë të përafrojnë plotësisht legjislacionin shqiptar me atë të vendeve të BE.



On **17 October 2014**, GDPT endorsed a collaboration memorandum with NRC, which is the sole responsible institution for registering the business in Albania, created by Law no. 9723, dated 03/05/2007 “On National Registration Centre”, as amended, with the goal to develop the policies on promotion of Industrial Property rights for raising the awareness of businesses on the rights they are entitled regarding the trademark and service mark, the industrial design or the registered geographical indicator. This agreement aims to create adequate conditions for the raising the awareness of businesses to the registration of Industrial Property objects and to strengthen the cooperation between these two institutions.

In this framework, members from GDPT have trained NRC personnel in various districts, namely as follows:

- i. On 24 October 2014 in Fier.
- ii. On 27 October 2014 in Vlora.
- iii. On 6 November 2014 in Gjirokastra.
- iv. On 11-12 November 2014 in Korça.
- v. On 20 November 2014 in Durrës.

During the meeting, the NRC personnel was informed on the importance and procedures of the registration of IP objects and provided NRC information materials on business.

- On **18 February 2014**, was held the fifth meeting of EU-Albania subcommittee on Agriculture and Fishing. In this meeting, the General Directorate of Patents and Trademarks presented a material on Geographical Indicators in Albania, and the related amendments made to the draft law on Industrial Property. These amendments aim to completely approximate the Albanian legislation with that of EU countries.

- Në **8 Prill 2014**, , Dhoma Amerikane e Tregtisë, organizoi në Sky Toëer një takim me Stakeholders Group (Mbajtësit e të Drejtave), për çështjet e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (IPR).

Takimi kishte në fokus:

- Njohjen me drejtuesit e rinj të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës, në fushën e Pronësisë Intelektuale.
- Prezantimin e aktiviteteve të kryera nga institucionet përgjegjëse në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010-2015 (VKM nr. 760 datë 01.09.2010).
- Diskutime mbi Konferencën e IPR-it e cila do të ketë në fokus Inspektimin e Tregut mbi çështjet e IPR-it.

DPPM prezantoi situatën aktuale të legjislacionit në fushën e PI në Shqipëri, arritjet e deritanishme të DPPM dhe angazhimet e saj në të ardhmen si për realizimin e detyrave funksionale dhe në drejtim të realizimit të objektivave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të PI.

- Në datë **24 Prill 2014** në ambjentet e Ministrisë së Bujqësisë u zhvillua mbledhja e Komitetit Drejtues të projektit MADA me temë “Zhvillimi i qëndrueshëm rural në malet e Ballkanit”. Takimi u organizua nga MADA (Mountain Areas Development Agency) dhe CIHEAM lam Montpellier dhe u mbështet nga Agjensia Franceze e Zhvillimit. Ndër temat e diskutuara ishin treguesit gjeografikë në Shqipëri. Në takim doli në pah se sa e rëndësishme është puna që duhet të bëjnë Shoqatat me prodhuesit e treguesve gjeografikë për regjistrimin e tyre, si dhe sa rëndësi ka bashkimi i prodhuesve për krijimin e shoqatave. Gjithashtu me kujdes duhet parë se çfarë rëndësie ka për ekonominë prodhimi i një produkti tradicional si dhe kërkimi i tregjeve për eksport të këtyre produkteve.
- Në datë **25 prill 2014** Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, Z. Elvin Lako, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të zhvilluar në Hotel Sheraton nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri (CCIFA), me mbështetjen e Ambasadës së Francës. Kjo tryezë kishte për qëllim informimin rreth kuadrit ligjor europian në fushën e ruajtjes së emërtimeve gjeografike, rreth projektit Biodiv Ballkan, që Qeveria Franceze financon në Shqipëri, si dhe rreth praktikave të para të implementuara në këtë kuadër.

- On **8 April 2014** at Sky Tower, the American Chamber of Commerce organised a meeting with the Stakeholders Group (Right Holders) on issues of Intellectual Property Rights (IPRs).

The meeting was focused on the following:

- Acquainting the new leaders of institutions responsible for the implementation of the respective legislation in the area of Intellectual Property.
- The introduction of activities done by the responsible institutions in the framework of the implementation of the Intellectual Property National Strategy 2010-2015 (Decision of the Council of Ministers no. 760, dated 01/09/2010).
- Discussions on IPR Conference which shall focus on Market Inspection regarding IPR issues. GDPT introduced the current legislation situation in IP for Albania, its current achievements of GDPT and future engagements in performing its functional duties and in meeting the objectives set forth in IP National Strategy.

- On **24 April 2014**, in the premises of the Ministry of Agriculture the meeting of MADA project Steering Committee was held on “The sustainable rural development in the mountains of Balkans”. The meeting was organised by MADA (Mountain Areas Development Agency) and CIHEAM lam Montpellier and supported by the French Development Agency. The geographical indicators in Albania were one of the topics of the discussions. The meeting emphasised the importance of the work which should be done by the associations with the geographical indicator producers regarding their registration and the importance of the unity of producers to establish associations. Also, attention was given to observe the importance of a traditional product manufacturing to the economy, together with the search for markets to export these products.
- On **25 April 2014**, the General Director of GDPT, Mr Elvin Lako, participated in the round table organised in Sheraton Hotel by the Chamber of Commerce and Industry France-Albania (CCIFA), with the support of the Embassy of France. The aim of this round table was to provide information regarding the European legal framework in the field of the protection of geographical

Z. Elvin Lako prezantoi situatën aktuale të legjislacionit në Shqipëri si dhe përmirësimet e propozuara në projektligjin e hartuar për përmirësimin e procedurave të regjistrimit të treguesve gjeografikë.

- Në datë **26 Prill 2014** Në bashkëpunim me Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë merr pjesë në Festivalin e Librit dhe Artit Pamor, i organizuar në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar, për të promovuar Pronësinë Intelktuale dhe luftën kundër falsifikimit si dhe për të sjellë në vëmendjen e qytetarëve, bizneseve dhe subjekteve të tjera, këtë ditë dhe rëndësinë e saj. Aktivitetet e ditës së Pronësisë Intelktuale konsistuan gjithashtu në shpërndarjen e buletinëve, afishimit të posterave me imazhe dhe mesazhe ndërgjegjësimi, dhe transmetimin e një kronike përmbledhëse për këto aktivitete brenda edicionit të lajmeve në kanal televiziv A1 Report.
- Në datë **26 Prill 2014**, DPPM në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës, organizoi një seminar trajnues me studentët të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Ky seminar u organizua për të promovuar Qendrën Teknike Shkencore të hapur në ambjentet e Univeristetit. Përfaqësues të DPPM shpjeguan rëndësinë e patentave dhe mënyrën e kërkimit në bazat e të dhënave të DPPM , WIPO dhe EPO.
- Në datë **22 Maj 2014**, në kuadër të projektit “EU Twinning AL2011/IB/FI/01, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me DPPM zhvilloi në ambientet e AGNA Group një workshop me temë: “Progresi dhe Sfidat në fushën e Pronësisë Intelktuale”. Përfaqësuesja e DPPM mbajti një prezantim me temë: “ Të drejtat e PI- Strategjia e PI 2010-2015- objektivat e saj - Arritjet e DPPM në vitet e fundit”. Avokatë që merren me çështje të PI dhe mbajtës të të drejtave diskutuan në lidhje me luftën kundër produkteve të falsifikuara.



denominations, Biodiv Balkans Project that France is funding in Albania and the first implemented practices in this framework. Mr Lako presented the actual situation of the Albanian legislation and the improvements proposed in the draft law on the improvement of procedures for the registration of geographical indicators.

- On **26 April 2014**, in cooperation with the International Chamber of Commerce, GDPT participates in the Book and Visual Arts festival, organised in the premises of National History Museum to promote Intellectual Property and the struggle against counterfeiting and to remind the citizens, businesses and other entities of this day and its importance. The activities of Intellectual Property Day also consisted on the distribution of bulletins, displaying of posters with images and awareness raising messages and on the transmission of a summarising report on these activities featured in the news edition on A1 Report TV channel.
- On **26 April 2014**, GDPT in cooperation with the Polytechnic University of Tirana organised a training workshop with the students of the Mechanical Engineering Faculty. This workshop was organised to promote the Technical and Scientific Centre opened in the premises of the university. Representatives from GDPT explained the importance of patents and the search method in GDPT, WIPO and EPO databases.
- On **22 May 2014**, in the framework of “EU Twinning AL2011/IB/FI/01” project, the General Directorate of Customs, in cooperation with GDPT organised a workshop in AGNA Group premises called: “Progress and challenges in the area of Intellectual Property”. The representative of GDPT conducted a presentation on: “IP right - IP strategy 2010-2015, Its goals and the achievements of GDPT Lawyers dealing with IP issues and right holders discussed on the struggle against counterfeited products.



Në datën **30 Shtator 2014**, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, organizoi, në mjediset e saj një takim me Përfaqësuesit e Autorizar një takim me temë, “Ndryshimet Ligjore në fushën e Markave Tregtare dhe të Shërbimit , Dizenjove Industriale dhe Treguesit Gjeografikë”. Ky takim kishte për qëllim prezatimin tek Përfaqësuesit e Autorizuar, ndryshimet e miratuara me hyrjen në fuqi në datë 10.07.2014 te Ligjit 55/14 ,datë 29.05.2014;“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale;” të ndryshuar”

On **30 September 2014**, The General Directorate of Patents and Trademarks organised in its premises a meeting with the Authorised Representatives on “Legal changes in the area of trademarks and service marks, industrial designs and geographical indicators”. This meeting was intended to introduce the Authorised Representatives to the approved amendments upon their entrance into force on 10/07/2014 of Law 55/14, dated 29/05/2014 “On some amendments and additions to law no. 9947, dated 07/07/2008 “On Industrial Property” as amended”



Në datën **16 Tetor 2014**, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, organizoi në mjediset e saj një takim me Përfaqësuesit e Autorizar të Patentave, me temë, “Ndryshimet Ligjore në fushën e Patentave të Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit”. Ky takim kishte për qëllim prezatimin tek Përfaqësuesit e Autorizuar, ndryshimet e miratuara me hyrjen në fuqi në datë 10.07.2014 te Ligjit 55/14 , datë 29.05.2014;“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale;” të ndryshuar”

On **16 October 2014**, The General Directorate of Patents and Trademarks organised in its premises a meeting with the Authorised Representatives of the Patents on “Legal changes in the area of invention patents and utility models”. This meeting was intended to introduce the Authorised Representatives to the approved amendments upon their entrance into force on 10/07/2014 of Law 55/14, dated 29/05/2014 “On some amendments and additions to law no. 9947, dated 07/07/2008 “On Industrial Property” as amended”



Në datën **21 Nëntor 2014**, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës organizoi, një seminar trajnues me temë “Patentat e shpikjeve dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit”. Studentët u trajnuan në lidhje me Patentën si koncept, përfitimet që ajo sjell si dhe mënyrat e mbrojtjes së saj. Gjithashtu, studentët u njohën me mënyrën e kërkimit të një patente në faqen zyrtare të DPPM, WIPO dhe EPO si dhe me shërbimet on-line që DPPM ofron.

On November 21st, 2014, the General Directorate of Patents and Trademarks, in cooperation with the Polytechnic University of Tirana organised a training seminar called “Invention patents and their effect in the economic development of the country”. The students were trained on the patent as a concept, the benefits it brings and the methods on protecting it. Also, the students were informed on the method of searching for a patent in the official web page of GDPT, WIPO and EPO and with the on-line services GDPT provides.

Në datat **23 dhe 29 Dhjetor**, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, me qëllim përmbushjen e misionit të saj, të forcimit të sistemit të mbrojtjes së Pronësisë Industriale në Shqipëri, ka ndërmarë një nismë për reformimin e tij, duke nisur fillimisht me vlerësimin e mangësive ligjore. Për këtë qëllim DPPM organizoi në mjediset e saj takime me Përfaqësuesit e Autorizar të Patentave, i cili do të pasojë me takime të tjera me grupet e interesit.

On **23 and 29 December**, the General Directorate of Patents and Trademarks has undertaken an incentive to reform itself, starting with the assessment of legal deficiencies, in order to accomplish its mission in strengthening the Industrial Property protection system in Albania. Pursuant to this, GDPT organised meetings in its premises with Patent Authorised Representatives, which shall continue in further meetings with the stakeholders.



3- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Shqipëri lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale;

DPPM gjatë këtij viti ka realizuar një sërë aktivititesh promovuese dhe trajnuese në fushën e Pronësisë Industriale dhe konkretisht:

- **Në 26 Prill 2014**, DPPM realizoi një fushatë me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale si dhe rëndësinë e regjistrimit të patentave, markave tregtare, dhe për të vlerësuar kontributin e dhënë nga krijuesit dhe shpikësit në zhvillimin e shoqërisë. Në këtë ditë u publikua në ‘Gazetën Shekulli’ një informacion mbi PI dhe mbi rëndësinë e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale.
- Është bërë pjesë e Panairëve Kombëtarë Lëvizës 2014 ,në Vlorë **në datat 6-8 Qershor**, në Korçë **në datat 20-22 Qershor**, në Shkodër **në datat 27-29 Qershor** dhe në Gjirokastër **në datat 17- 20 Shtator**.

Panairët Kombëtarë Lëvizës kishin në fokus biznesin dhe përmes tij, ishin një mundësi për të promovuar Pronësinë Industriale, duke nxitur inovacionin, duke synuar informimin në lidhje me markat, patentat, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, rëndësinë e regjistrimit të tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave se bashku me agjensi dhe instanca të tjera shtetërore të përfshira në misionin e këtij Panairi mundësuan transparencë dhe informacion për të gjitha shërbimet që i’u ofrohen bizneseve.

- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave nisi një fushatë sensibilizimi të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ky cikël seminaresh trajnuese për bizneset nisi në qytetin e Vlorës **në datë 17 Nëntor 2014** dhe vazhdoi me trajnimet që u zhvilluan në qytetin e Korçës **në datën 24-25 Nëntor**. Përfaqësues të DPPM prezantuan informacione rreth objekteve të Pronësisë Industriale si: markat tregtare dhe të shërbimit, patentat e shpikjeve, dhe treguesit

3- Raising awareness among the general public in Albania regarding the intellectual property rights;

During this year the GDPT has realised a series of promotional and training activities in the field of Industrial Property, specifically:

- On **26 April 2014**, GDPT completed a campaign aiming to raise the awareness of the public on the importance of the protection of Industrial Property rights and on the importance of patent and trademark registration and to evaluate the contribution given by creators and inventors in the development of the society. “Shekulli” newspaper on the same day published information on IP and on the importance of World Intellectual Property Day.
- It has become part of the National Mobile Fairs 2014 in Vlorë in **6-8 June**, in Korça in **20-22 June**, in Shkodra in **27-29 June** and in Gjirokastra in **17-20 September 2014**.

The National Mobile Fairs focused on the business and ways to improve it, they represented an opportunity to promote the Industrial Property, by stimulating innovation, aiming to inform the public on the marks, patents, industrial designs and geographical indications, and the importance of their registering.

The General Directorate of Marks and Patents together with other government agencies and bodies included in the mission of this Fair, provided transparency and information regarding all the services provided to businesses.

- The General Directorate of Patents and Trademarks initiated an awareness raising campaign, extended throughout the Albanian territory. This cycle of business training workshops started in Vlorë on **17 November 2014** and continued with the trainings held in Korça on **24-25 November**. Representatives from GDPT presented information about Industrial Property objects such as: trademarks and service marks, invention patents and geographical indicators. They emphasised their importance in the economic development, their registration procedures

gjeografikë. Ato theksuan rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik, procedurat e regjstrimit të tyre, si edhe shërbimet elektronike që DPPM ofron. Regjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale i krijon mundësinë kompanive të mbrohen nga konkurenca e pandershme, të ndalojnë kompanitë e tjera të përdorin marka të ngjashme apo identike me markën e tyre të regjistruar më parë. Në këto seminare morën pjesë rreth **82 biznese**.

and the electronic services GDPT provides. The registration of Industrial Property objects enables the companies to protect themselves from unfair competition and prohibits other companies to use trademarks similar or identical to their previously registered trademark. These workshops were attended by around **82 businesses**.



- **Në datën 11 Dhjetor 2014**, ky cikël seminaresh trajnuese për bizneset vijoi në qytetin e Durrësit. Përfaqësues të DPPM prezantuan informacione rreth Pronës Industriale, rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik, procedurave të regjstrimit të saj, si edhe shërbimet elektronike që DPPM ofron. Në këto seminare morën pjesë rreth **35 biznese**.

- On **11 December 2014**, this cycle of business training seminars continued its journey in Durrës. Representatives from GDPT presented information related to Industrial Property, its importance in the economic development, its registration procedures and the electronic services GDPT provides. These workshops were attended by around **35 businesses**.



Të pranishmit paraqiten interes dhe shprehën nevojën për të proceduar menjëherë për regjistrimin e markave të produkteve dhe/apo shërbimeve që ato ofrojnë.

The participants showed interest and expressed their need to proceed immediately with the registration of their product marks and/or services they provide.

4-Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale (2010-2015).

